



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM
Nr. 70, Datë 11.04.2022

**MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 489, SERIA P21, NË
VEPRITMARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË
“GERTI” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 5, gërma “a” dhe nenit 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/3 prot., datë 04.04.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “GERTI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “GERTI” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021”,

Konstatohet se:

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021, është licencuar shoqëria “GERTI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW”.
- Në këtë vendim, ndër të tjera është vendosur që: 2. Shoqëria të depozitojë në ERE Pasqyrat Financiare të vitit 2020 ku pasqyrohen asetet fikse të transferuara nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., tek shoqëria “GERTI” sh.p.k., brenda datës 30.06.2021 dhe 3. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE finalizimin e heqjes nga fondi pyjor kullor të sipërfaqes së përcaktuar për zhvillimin e projektit, jo më vonë se një muaj nga disponimi i tij.
- ERE nëpërmjet shkresave të përsëritura i është drejtuar shoqërisë “GERTI” sh.p.k., përmendimin këtu: komunikimin shkresor që kthehej nga posta si adresë e pasaktë, komunikimin me e-mail me shoqërinë ku është konfirmuar adresa e njëjtë me atë që shërbimi postar kthente shkresat edhe komunikimin telefonik me përfaqësues të shoqërisë. ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 67 prot., datë 14.01.2022, me lëndë: “Njoftim për zhvillimin e një seancë dëgjimore”, e cila u zhvillua në ambientet e ERE-s më datë 21.01.2022, në të cilën shoqëria saktësoi numrin e apartamentit të adresës së selisë, i cili ndryshonte nga numri i apartamentit të deklaruar më herët nga ajo.
- Sa i përket kushtit të pikës 2, të bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021, i cili ka të bëjë me depozitimin e pasqyrave financiare të vitit 2020, sikurse edhe vetë shoqëria deklaroi, konstatohet

se në to nuk pasqyrohen asetet fikse të transferuara nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. tek shoqëria “GERTI” sh.p.k. Ashtu siç deklaruar dhe në seancën dëgjimore, shoqëria pretendon se transferimi i aseteve ka ndodhur në datën 30.06.2021 dhe për këtë disponon Faturën Tatimore të Shitjes, të cilën e ka depozituar në ERE. Nga fatura nr. 06, datë 30.06.2021, e cila ka përshkrimin Punime Ndërtimi viti 2019 – 2020 HEC “Vardari”, rezulton se nuk mund të verifikojmë kalimin e aseteve pasi me përshkrimin e dhënë në këtë faturë shërbimi, nuk specifikohen se cilat zëra/asete të paluajtshme janë transferuar nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. te shoqëria “GERTI” sh.p.k. Ndaj dhe shoqërisë iu kërkua dokumentimi i rregullimit pronësor, në kuptim edhe të sa përcjellin pasqyrat financiare.

Sa më sipër, rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar kushtin nr. 2, të vendimit nr. 99/2021.

- Sa i përket kushtit të pikës 3, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.04.2021, i cili ka të bëjë me heqjen nga fondi pyjor kullësor të sipërfaqes së përcaktuar për zhvillimin e projektit, dhe depozitimin në ERE jo më vonë se një muaj nga disponimi i vendimit për heqjen nga fondi pyjor; si dhe kushtit të vendosur në pikë 1 të dispozitivit, që ka të bëjë me zëvendësimin e palës qiramarrëse në Kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., dhe Bashkisë Librazhd “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, Ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari”, konstatohet se:

Nga periudha e licencimit kujtojmë se në lidhje me Kontratën 10 vjeçare të qirasë më të drejtë rinovimi të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, Ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari”, shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën nr. 31 prot., datë 18.03.2021, drejtuar Bashkisë Librazhd me lëndën “Kërkesë për ndryshim emri të subjektit të HEC Vardari”, me anë të së cilës i kërkon bashkisë Librazhd ndryshimin e emrit të subjektit nga “Drini Bulqizë” sh.p.k në “GERTI” sh.p.k pasi ky i fundit është zotëruar i kontratës për ndërtim, shfrytëzim dhe administrim të HEC-it Vardari, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan nr. 1848 Rep., Nr. 388/1 Kol., lidhur me MIE-n në datën 24.12.2020, Amendim Kontrate, “Për Kontratën e Ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 MW, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjes, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan

Sa më sipër rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar kushtin nr. 3, të vendimit nr. 99/2021.

- Për sa më sipër, meqenëse kushtet e vendimit të bordit të ERE-s nr. 99/2021, mbetën ende të pa plotësuar, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 67/4 prot., datë 23.02.2022, e cila rezulton e kthyer dy ditë më pas dhe me tej është ridërguar më datë 03.03.2022 dhe pas kësaj date nuk rezulton të jetë kthyer më nga shërbimi postar.
- Në parashikim të nenit 5, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, duke qenë se shoqëria “GERTI” sh.p.k. është licencuar me kushtet përkatëse të shprehura në vendimin nr. 99/2021, të cilat nuk ka arritur t’i

përmbushë brenda afateve e po ashtu nuk ka dokumentuar as përpjekjet e saj për plotësimin e tyre, vlerësohet se jemi përpara fillimit të një procedure për heqjen e licencës së saj.

- Në çdo rast shoqëria ka të drejtën e saj për t'u përgjigjur me shkrim, siç përcaktohet në nenin 7, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, i cili përcakton si vijon: *Me nisjen e procedurës për heqjen e një licence, sipas kushteve të përcaktuara në gërmat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe /ose d të nenit 5, të kësaj rregulloreje ERE:*
 - a) njofton me shkrim të licencuarin për fillimin e procedurave për heqjen e licencës duke shprehur qartësisht arsyet për heqjen e licencës;*
 - b) respekton të drejtën e të licencuarit për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës;*
 - c) kur është në interesin publik, mund t'i japë të licencuarit 30 ditë kohë, pas përgjigjes së tij me shkrim, që të veprojë në përputhje me kushtet e licencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e saj.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës së shoqërisë “GERTI” sh.p.k., nr. 489, Seria P21, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW”.
2. Shoqëria “GERTI” sh.p.k. ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI